



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2022:279310  
Datë: 03.09.2024  
Numri i dokumentit: 06114173

**C.nr.1908/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil**, me gjyqtarin Nazmi Neziri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. Z. nr. personal....., të cilin e përfaqëson i autorizuari A. S., avokat, me autorizim, kundër të paditurit A. A. nr. personal ..., nga , tani me vendbanim në , baza e kontestit për Vërtetim pronësie, me vlerë kontesti: 4,800.00 euro, jashtë seancës me datë 03.09.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET** se është tërhequr padia e paditësit S. Z., kundër të paditurit A. A., baza e kontestit për Vërtetim pronësie.

Secili palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Gjykata lidhur me çështjen konkrete juridike pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës, konstaton se paditësi-i autorizuari i tij me parashtresën e datës 02.09.2024, ka theksuar se bëjmë tërheqjen e padisë, pasi që palët ndërgjygjëse kanë arritur marrëveshje për zgjidhjen e çështjes objekt i padisë, për çka marrëveshja është formalizuar në zyrën noteriale me nr. – numri i referencës i dt. – data e dokumentit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me nenin 261.1, të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), është përcaktuar se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*, ndërsa me nenin 261.3 të njëjtit ligj është paraparë se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë.”*, kurse në nenin 261.4, thuhet se: *“Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi.”*

Andaj, si rezultat i kësaj, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në mbështetje të nenit 261.1, 3 dhe 4 si dhe nenit 387.1 (c) dhe 450 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore të Kosovës (LPK-së).

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.1908/2022 më datë 03.09.2024**

**Gjyqtari:**  
Nazmi Neziri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.